



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 825/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.12.2018, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 1755 prot., datë 19.11.2018 për procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr.REF-90640-10-19-2018 me objekt: “*Projektimi i Zonës së Plazhit Durrës,*” me fond limit 41.624.734 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 06.11.2018 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues:

“Archispace” sh.p.k & “Gjeokonsult & Co” sh.p.k .
Rr “Abdyl Frashëri”, Nr.31, Q.Biznesit HEKLA, Kati III, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga “Sami Frashëri”, Nr.10,Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:


I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.



II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.10.2018 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr.REF-90640-10-19-2018 me objekt: “*Projektimi i Zonës së Plazhit Durrës,*” me fond limit 41.624.734 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.11.2018 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 07.11.2018 KVO-ja ka përfunduar në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përfundimtar të ofertave lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit. Ofertuesi ankimues është njoftuar elektronikisht për arsyet e skualifikimit të tij në këtë procedurë.

II.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në autoritetin kontraktor në datën 09.11.2018 duke kundërshtuar skualifikimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Archispace” sh.p.k & “Gjeokonsult & Co” sh.p.k në procedurën e prokurimit.

II.4. Në datën 09.11.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën

II.5. Në datën 19.11.2018 ankimuesi ka dorezuar ankese prane KPP, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 21.11.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1755/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 1477/2 prot., datë 20.11.2018 me objekt: “*Dërgim informacioni*”, bashkëlidhur informacioni dhe dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

II.7. Në datën 04.12.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr.REF-90640-10-19-2018 me objekt: “*Projektimi i Zonës së Plazhit Durrës,*” me fond limit 41.624.734 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 06.11.2018 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Archispace” sh.p.k & “Gjeokonsult & Co” sh.p.k për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr.REF-90640-10-19-2018 me objekt: “*Projektimi i Zonës së Plazhit Durrës,*” me fond limit 41.624.734 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 06.11.2018 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i drejtohet ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” i cili në nenin 94, “*Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës*”, pika 1 parashikon se “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.*”

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimimin e tij, dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga

ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Shërbim Konsulence”, me Nr.REF-90640-10-19-2018 me objekt: “Projektimi i Zonës së Plazhit Durrës,” me fond limit 41.624.734 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 06.11.2018 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1755 Protokoli

Datë 19.11.2018



KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha